# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-444318**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Vuçiç njofton dorëheqjen më 27 shtator, hyn në fushatë për zgjedhjet e parakohshme të 25 tetorit |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/rajoni/vucic-njofton-doreheqjen-me-27-shtator-hyn-ne-fushate-per-zgjedhjet-e-par-i586122` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 19:16:11 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 19:10:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `da07b3350be15c148da717db9f4bdcb1dae528349c5ce615ee05f2d615ab1155` |
| TEKSTI | `a0fea9f46a82f767e2174185acc86a3b669137bedf6454145f2b03c87418a744` |
| PAMJA | `33dcc55a6be7612f914bbdebcb63b8534d90ff2ce700797f90eadc6ea8fc180c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1f1d687fe340e581012d8122f42558e03606d3ff76f7048ce315b5680dd23ee3` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `05fd12c73e666390d825ec78dbf996bd3e8990e77e2d97cbe701da17a7d0f007` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1f1d687fe340e581012d8122f42558e03606d3ff76f7048ce315b5680dd23ee3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Vuçiç njofton dorëheqjen më 27 shtator, hyn në fushatë për zgjedhjet e parakohshme të 25 tetorit

14 Shtator 2026, 21:10Rajoni TEMA



Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ka njoftuar se do të japë dorëheqjen nga posti i kreut të shtetit më 27 shtator.

Gjatë një interviste në TV Pink, Vuçiç tha se atë mbrëmje do t'u drejtohet qytetarëve dhe do t'i falënderojë për mbështetjen ndaj tij

“Dua t'ju njoftoj se më 27 shtator do të jap dorëheqjen nga posti i presidentit. Atë mbrëmje do t'u drejtohem qytetarëve dhe do t'i falënderoj për mbështetjen. Kam qenë presidenti i Republikës për kohën më të gjatë që nga vendosja e sistemit shumëpartiak në vendin tonë. Këtë nuk do të mund ta bëja pa qytetarët e këtij vendi. E vetmja gjë që mund të them është se i kam shërbyer me besnikëri Serbisë dhe qytetarëve të saj, me përkushtim dhe duke luftuar”, u shpreh Vuçiç.

“Më pas do të shkoj në fushatën zgjedhore të 25 tetorit si një qytetar i zakonshëm”, shtoi presidenti serb.

“Kam marrë edhe një automjet, kam edhe makinën time. Kam marrë edhe një kamping, pasi nuk do të mund të fle kudo. Do të shkoj në fshatrat më të largëta, do të qëndroj deri vonë. Ka ende shumë fshatra ku nuk kam qenë. Dua të vizitoj edhe qytetet, të flas me njerëzit para dyqaneve, para lokaleve”, deklaroi ai.

Serbia do të mbajë zgjedhje të jashtëzakonshme parlamentare më 25 tetor. Më 9 shtator, presidenti Aleksandar Vuçiç shpërndau zyrtarisht Kuvendin dhe firmosi dekretin për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme, pas muajsh tensionesh politike dhe protestash kundër korrupsionit. Vetë Vuçiç, mandati i dytë dhe i fundit presidencial i të cilit do të përfundonte në vitin 2027, do të udhëheqë listën zgjedhore të Partisë Përparimtare Serbe (SNS) dhe është kandidati i saj për postin e kryeministrit.

Zgjedhjet zhvillohen në një klimë të fortë polarizimi politik, pas protestave të nisura pas tragjedisë në stacionin hekurudhor të Novi Sadit në nëntor 2024, ndërsa përballë SNS-së pritet të garojnë edhe lista e studentëve, e dalë nga lëvizja protestuese, si dhe koalicione të tjera opozitare.

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Lumir Abdixhiku: Bekim Sejdiu tregoi dinjitet]

20:50 Rajoni

Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Reuters: Kosova pret një vendim që mund të trondité raportet me Perëndimin

20:25 Rajoni

[Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura për President të Kosovës]

20:00 Rajoni

[Verdikti për ish-krerët e UÇK-së më 16 shtator, Policia e Kosovës merr masat, paralajmërohen kufizime të përkohshme të qarkullimit]

18:40 Rajoni / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.